

SHQIPËRI



VS

GJEORGJI



UEFA
NATIONS
LEAGUE™



LIGA B | GRUPI 1

AIR ALBANIA
STADIUM

10 SHTATOR 2024, ORA 20:45

B1

KALENDARI I NDESHJEVE NË UEFA NATIONS LEAGUE



R E N D I T J A

SKUADRA	NL	F	B	H	GSH	GP	DG	P
GJEORGJI	1	1	0	0	4	1	3	3
SHQIPËRI	1	1	0	0	2	1	1	3
UKRAINË	1	0	0	1	1	2	-1	0
ÇEKI	1	0	0	1	1	3	-3	0



TË DASHUR TIFOZË DHE MIQ TË FUTBOLLIT SHQIPTAR,

Është gjithmonë një moment special kur Kombëtarja jonë e dashur rikthehet në fushën e lojës për të përfaqësuar me krenari ngjyrat kuqezi. Pas fitores madhështore ndaj Ukrainës, ne jemi sot të mbushur me besim dhe shpresë, ndërsa përgatitemi për një sfidë të re kundër Gjeorgjisë në shtëpinë tonë, në stadiumin "Air Albania".

E gjithë skuadra ka treguar zemër, disiplinë dhe përkushtim të jashtëzakonshëm në ndeshjen e parë të kompeticionit dhe besoj se ky është vetëm fillimi i një udhëtimi që do të na çojë drejt rezultateve që të gjithë duam. Fitorja ndaj Ukrainës nuk ishte e lehtë, por lojtarët tanë treguan vullnet të hekurt, duke krenuar Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

Shqipëria është një vend me zemër të madhe, me talente të jashtëzakonshme që po shkëlqejnë në arenën ndërkombëtare, duke na dhënë forcën për të besuar se e ardhmja jonë është e ndritur. Fitorja ndaj Ukrainës ishte një shembull i qartë i progresit tonë dhe i asaj që mund të arrijmë kur luajmë me zemër dhe disiplinë. Sot ne presim të bëjmë një tjetër hap të madh drejt suksesit.

Të martën mbrëma, përballë Gjeorgjisë, do të kemi një tjetër mundësi për të treguar se jemi në rrugën e duhur. Ndeshjet nuk janë kurrë të thjeshta, çdo kundërshtar sjell sfidat e veta, por besimi im te djemtë e Kombëtares dhe stafi teknik është i patundur. Ata kanë demonstruar me plot krenari dhe pasion se Shqipëria nuk është më thjesht një pjesëmarrëse në kompeticionet më të mëdha, por një konkurrenca serioze në çdo nivel ndërkombëtar.

Kjo ndeshje ndaj Gjeorgjisë nuk është thjesht një përballje sportive, por një mundësi për të treguar që Shqipëria është e përgatitur për sfida të mëdha. Futbollit është forca jonë bashkuese dhe me çdo fitore, ne ndërtojmë të ardhmen tonë. Falënderoj nga zemra çdo lojtar, trajner dhe tifoz për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm. Ky brez i lojtarëve ka potencialin të na dhurojë suksese të mëdha. Shumë prej tyre po luajnë në kampionate prestigjioze, duke fituar eksperiencë dhe përmirësuar aftësitë e tyre në nivelin më të lartë të futbollit. Ata janë shembulli më i mirë se si Shqipëria po përparon dita-ditës, dhe se e ardhmja jonë është premtuese.

Suksesi i kuqezinjve nuk do mund të jetë i plotë pa tifozët tanë të zjarrtë. Ata janë forca shtytëse e këtij ekipi. Janë lojtari ynë i 12-të, ata që na japin energjinë dhe pasionin e nevojshëm për të luftuar deri në fund. Stadiumi "Air Albania", me tifozët në tribuna, bëhet një fortesë e vërtetë. Në këtë shtëpi të bukur, përballë Gjeorgjisë, ne do të tregojmë edhe një herë se me mbështetjen e të gjithëve, gjithçka është e mundur.

Le të bashkohemi të gjithë të martën në mbrëmje, le të mbështesim skuadrën tonë me gjithë fuqinë tonë dhe le të tregojmë se sa shumë kemi përparuar si një komb futbollistik. Shqipëria është një vend me histori, me traditë, dhe me pasion, dhe Kombëtarja jonë është krenaria jonë më e madhe.

Së bashku, do të korrim fitore të tjera historike dhe do të vazhdojmë të shkruajmë historinë e futbollit shqiptar.

Faleminderit dhe përpara kuqezinj!



ARMAND DUKA

PRESIDENT I FEDERATËS
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT



BOTIM ZYRTAR I
FEDERATËS SHQIPTARE
TË FUTBOLLIT



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Themeluar:	1930
Pranohet në FIFA:	1932
Pranohet në UEFA:	1954
President:	Armand Duka
Sekretar i Përgjithshëm:	Ilir Shulku
Trajner:	Sylvio Mendes Campos Júnior
Stadiumi ku luan:	“AIR ALBANIA” TIRANË “ELBASAN ARENA”, Elbasan “Loro Boriçi”, Shkodër
Lojtari me më shumë ndeshje:	Lorik Cana, 93 ndeshje



SHQIPËRIA

LISTA E KOMBËTARES



NAME	SURNAME	POSITION	CLUB
Thomas	Strakosha	Goalkeeper	AEK Athens
Alen	Sherri	Goalkeeper	Cagliari
Simon	Simoni	Goalkeeper	FC Ingolstadt
Elseid	Hysaj	Defender	Lazio
Ivan	Balliu	Defender	Rayo Vallecano
Andi	Hadroj	Defender	FK Partizani
Mario	Mitaj	Defender	Al-Ittihad
Adrian	Bajrami	Defender	Benfica
Marash	Kumbulla	Defender	Espanyol
Ardian	Ismajli	Defender	Empoli
Enea	Mihaj	Defender	Famalicao
Ylber	Ramadani	Midfield/attack	Lecce
Amir	Abrashi	Midfield/attack	Grasshoppers
Kristjan	Asllani	Midfield/attack	Inter
Medon	Berisha	Midfield/attack	Lecce
Qazim	Laçi	Midfield/attack	Sparta Praha
Nedim	Bajrami	Midfield/attack	Rangers
Arbër	Hoxha	Midfield/attack	GNK Dinamo
Jasir	Asani	Midfield/attack	Gwangju FC
Sebastjan	Spahiu	Midfield/attack	Mes Rafsanjan
Agim	Zeka	Midfield/attack	FK Partizani
Rey	Manaj	Midfield/attack	Sivasspor
Myrto	Uzuni	Midfield/attack	Granada
Taulant	Seferi	Midfield/attack	Bodrum FK



FEDERATA E FUTBOLLIT SË GJEORGJISË

Themeluar	1936
Pranohet në FIFA	1992
Pranohet në UEFA	1992
President	Levan Kobiashvili
Sekretar i përgjithshëm	David Mujiri
Trajner	Willy Sagnol
Stadiumi ku luan	Boris Paichadze Dinamo Arena
Lojtari me më shumë ndeshje	Guram Kashia, 117 ndeshje



GJEOORGJIA

LISTA E KOMBËTARES



NAME	SURNAME	POSITION	CLUB
Giorgi	Mamardashvili	Goalkeeper	Valencia
Giorgi	Loria	Goalkeeper	Omonia Aradipou
Luka	Gugeshashvili	Goalkeeper	Panseraikos
Guram	Kashia	Defender	Slovani
Otar	Kakabadze	Defender	Krakow
Giorgi	Gvelesian	Defender	Persepolis
Lasha	Dvali	Defender	Apoel
Luka	Lochoshvili	Defender	Cremonese
Giorgi	Gocholeishvili	Defender	Copenhagen
Irakli	Azarov	Defender	Shakhtar
Luka	Gadran	Defender	Kairati
Jimmy	Tabidze	Defender	Dinamo Makhachkala
Giorgi	Chakvetadze	Midfield/attack	Watford
Otar	Kiteishvili	Midfield/attack	Sturm
Giorgi	Kochorashvili	Midfield/attack	Levante
Sandro	Altunashvili	Midfield/attack	Wolfsburg
Shota	Nonikashvili	Midfield/attack	Cherkassy
Giorgi	Tsitaisvili	Midfield/attack	Granada
Saba	Lobzhanidze	Midfield/attack	Atlanta United
Giorgi	Mikoutadze	Midfield/attack	Olympic Lyon
Budu	Zivzivadze	Midfield/attack	Karlsruhe
Khvicha	Kvaratskhelia	Midfield/attack	Napoli
Zuriko	Davitashvili	Midfield/attack	Saint-Etienne



LIGA E KOMBEVE

NJË SHANS PËR SHQIPËRINË PËR PLAY-OFF-in E BOTËRORIT

2026

Pas finaleve të Europianit “Gjermani 2024”, Kombëtarja shqiptare rikthehet në fushë në muajin shtator me dy sfidat ndaj Ukrainës e Gjeorgjisë, të vlefshme për Ligën e Kombeve.

Dy ndeshje shumë të rëndësishme për Shqipërinë, që synon vendin e parë në grup jo vetëm për t'u ngjitur në Ligën A për edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve, por edhe sepse përmes këtij kompeticioni, kuqezinjtë kanë një shans të artë për t'u kualifikuar në finalet e Kampionatit Botëror 2026. Por si ndodh kjo?

Nga kualifikueset e Kampionatit Botëror 2026, që nisin në muajin mars të vitit të ardhshëm, kalojnë automatikisht 12 vendet e para të grupeve, ndërsa 12 vendet e dyta shkojnë në fazën play-off. Këtyre 12 vendeve të dyta u bashkohen edhe 4 ekipe nga Liga e Kombeve. Ky kompeticion është i përbërë nga 4 liga: A, B, C, D dhe në bazë të paraqitjeve në grup, do të ketë edhe një klasifikim të përgjithshëm të të gjitha ligave. Kësioj, nëse kuqezinjtë do të renditen të parët në grupin B, atëherë mundësitë për të kapur fazën play-off të Botërorit janë më të mëdha

për shkak të ngjitjes lart në klasifikim. Pra, veç kualifikueseve të Botërorit, Shqipëria ka një shans shumë të mirë edhe me Ligën e Kombeve. Kuqezinjtë e drejtuar nga trajneri Silvinjo janë pjesë e Ligës B dhe janë pozicionuar në grupin B1 së bashku me Çekinë, Gjeorgjinë dhe Ukrainën.

Kjo fushatë ndeshjesh për Kombëtaren nisi zyrtarisht të shtunën e 7 shtatorit, me kuqezinjtë që u përballën me Ukrainën në stadiumin “Epet Arena”, ku triumfuan me përmbysje me rezultatin 1-2, me gola të Ardian Ismajlit dhe Jasir Asanit. Një fitore e rëndësishme drejt objektivit për vendin e parë në grup dhe mundësisë për t'u kualifikuar në finalet e Botërorit 2026.

Sonte kuqezinjtë do të luajnë në fortesën e tyre në Tiranë sfidën ndaj Gjeorgjisë, ku do të kërkojnë tre pikët në një stadium të mbushur me 22 mijë shqiptarë.



ARBITRAT E NDESHJES

Roli	Emër + Mbiemër	Kombësia
Arbitër	Erik Lambrechts	Belgjikë
Asistent Arbitër 1	Jo de Weirdt	Belgjikë
Asistent Arbitër 2	Kevin Monteny	Belgjikë
Arbitër i katërt	Nathan Verboomen	Belgjikë

#EQUALGAME





EQUAL GAME



SPONSOR GJENERAL:



SPONSOR TEKNIK:



PREMIUM SPONSOR:



SPONSOR ZYRTARË:



Vodafone GigaNet

Rrjeti më i mirë celular dhe fiks
në Shqipëri. I vetmi i certifikuar
nga Umlaut për vitin 2022.



Celular



Internet Fiks



TV

Ti mund të përjetosh gjithçka
në një rrjet që nuk njih limite

Together we can

